

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BE MAD” SH.P.K.

Sot, në Tiranë, më datën 11.12.2018 me cilesinë e ortakut themelues të shoqërisë:

Dea ELEZI, e datëlindjes 08.05.1998, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i paisur me letërnjoftimin ID me nr. J85508052S

ka vendosur themelimin e shoqërisë tregtare **“BE MAD” SH.P.K.**

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të një shoqërie tregtare, nënshkruesi dhe themeluesi i saj merr përsipër të realizojnë e të respektojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë:

THEMELIMI I SHOQËRISË

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar e emertuar **“BE MAD” SH.P.K.**

(me poshte ne kete akt e quajtur "Shoqeria") nga Ortaku themelues i saj.

FORMA E SHOQERISE

Shoqeria **“BE MAD” SH.P.K.** me poshte e referuar si "Shoqeria", eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar krijuar ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare", dhe rregullohet prej ketij ligji, dhe statutit te shoqerise si dhe prej cdo dispozite tjeter ligjore te aplikueshme.

Dea Elezi

II EMRI I SHOQERISE, SELIA, OBJEKTI DHE KOHEZGJATJA

Neni 1

Emri

Emri i shoqerise eshte **“BE MAD” SH.P.K.** Ne cdo dokument, fature, reklame dhe publikime emri i shoqerise do te pasohet nga:

- (i) fjala “me pergjegjesi te kufizuar” apo “sh.p.k”
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

Neni 2

Selia

Selia administrative e shoqerise do te jete ne Njësia Administrative 10, Rr. e Kavajës, Vila 17, Tiranë

Kohezgjatja

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise eshte per nje periudhe 10 vjecare, duke filluar prej momentit te regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

III. OBJEKTI I SHOQERISE

Neni 4

Objekti

Objekt i veprimtarise do te jete:

- Berja e nje analize biznesi te detajuar, duke i'u rreferuar te gjithë faktoreve kyc qe ndikojne ne suksesin e nje biznesi si atyre ekonomik, te marketingut , shitjeve etj; krijimi i identiteteve vizive te biznese duke perfshire ketu logotype, mock up, packing design, stationary collateral, social identity; krijimi i manualeve te Brand-eve; krijimi dhe planifikimi i fushatave te ndryshme te marketingut; kurimi i mediave sociale; analizimi i nevojave te bizneseve per rebrand-im; trajnim dhe asistence per implementimin e ketyre sherbimeve.

Dea Eleziuf

IV. KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

Neni 5

Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 5'000 (pesë mijë) leke.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1(nje) kuotë me nje vlere nominale te barabarte me 5'000 leke secila, te cilat zoterohen, si me poshte:

Znj. Dea ELEZI 100%

Neni 6

Organizimi

Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator. Kete detyre do ta kryej **Znj. Dea ELEZI**, e cila do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise, per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, me perjashtim te kompetencave qe ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblese se Ortakeve.

ORTAKU

Dea ELEZI



3

Dea Elezi ef

STATUT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"BE MAD" SH.P.K.

Ne mbeshtetje te ligjit nr . 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjit nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" qe rregullojne marredheniet tregtare dhe funksionimin e shoqerive, personat e meposhtem:

- **Dea Elezi**, e datelindjes 08.05.1998, lindur ne Tirane, dhe banuese në Tiranë, shtetase shqiptar, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, e pajisur me leternjoftimin ID me nr. 032642660 dhe nr. personal J85508052S.

me cilesine e ortakut themelues, hartoi kete statut te Shoqerise tregtare "**BE MAD**" sh.p.k. me dispozitat e meposhtme:

KAPITULLI I


Legjislacioni, Forma

Neni 1

Shoqeria "**BE MAD**" **Sh.p.k.**, qe ne vazhdim shkurtimisht do te quhet "shoqeria" eshte krijuar ne baze te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 2

Forma juridike e shoqerise eshte ajo e "*shoqerise me pergjegjesi te kufizuar*" prandaj pergjegjesia e ortakeve eshte e kufizuar deri ne shumen e pjeses se zoteruar nga kapitali themeltar.

1
Dea Elezi 

KAPITULLI II
Emertimi, Selia, Kohezgjatja

Neni 3

- Emertimi i shoqerise eshte: **“BE MAD” SH.P.K.**
- Ne cdo dokument, fature, reklame dhe publikime emri i shoqerise do te pasohet nga:
 - (i) fjala “me pergjegjesi te kufizuar” apo “sh.p.k”
 - (ii) numri i saj i regjistrimit
 - (iii) selia

Neni 4

- Selia e shoqerise ndodhet ne Tiranë, Rr. e Kavajës, vila 17, njësia administrative 10.
- Me vendim te Asamblese se Ortakut shoqeria mund ta zhvendose seline e saj operative ne nje qytet tjeter te Republikes se Shqiperise. Ne baze te ligjit shoqeria mund te hape apo krijoje seli dytesore dhe administrative, dege, filiale, agjenci, zyra perfaqesie si ne Shqiperi ashtu edhe jashte saj, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 5

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise **“BE MAD”** sh.p.k eshte per nje periudhe 10vjecare, duke filluar prej momentit te regjistrimit te saj prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

KAPITULLI III

Objekti

Neni 6

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise se saj:

Berja e nje analize biznesi te detajuar, duke i'u rreferuar te gjithë faktoreve kyc qe ndikojne ne suksesin e nje biznesi si atyre ekonomik, te marketingut , shitjeve etj; krijimi i identiteteve vizive te biznese duke perfshire ketu logotype, mock up, packing design, stationary collateral, social identity; krijimi i manualeve te Brand-eve; krijimi dhe planifikimi i fushatave te ndryshme te marketingut; kurimi i mediave sociale; analizimi i nevojave te bizneseve per rebrand-im; trajnim dhe asistence per implementimin e ketyre sherbimeve.

KAPITULLI IV

Kapitali Themeltar

Neni 7

- Kapitali themeltar i shoqerise eshte percaktuar ne shumen 5'000 (pesë mijë) leke.
- Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote me nje vlere nominale te barabarte me 5'000 leke secila, te cilat zoterohen, si me poshte: 100 % - znj. Dea ELEZI.

Neni 8

Zmadhimi i kapitalit

Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te Asamblese se Ortakut. Zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet me derdhje ne para

ose me kontribute ne natyre, ne kete rast keto kontribute duhet te shoqerohen me nje raport vleresimi tekniko-financiar te kryer nga nje ekspert i vleresimit te kontributeve, te emeruar nga Asambleja e Ortakut dhe qe duhet t'i bashkelidhet vendimit te Asamblese se Ortakut, ne momentin e regjistrimit te dokumentacionit prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 9

Zvogelimi i kapitalit

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet me vendim te Asamblese se ortakeve, me propozim te administratorit, vetem ne rastin kur shoqeria mund te pesoje humbje te tilla qe e bejne te domosdoshem kete zvogelim.

Ky veprim do te kryhet ne baze te dispozitave te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Neni 10

Transferimi i pjeseve te kapitalit

- Kuotat e kapitalit themeltar jane emerore dhe te transferueshme.
- Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarje pasurore mes bashkeshorteve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.
- Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin paraprak te shumices se ortakeve qe zoterojne $\frac{3}{4}$ e pjeseve dhe me kushte jo me te favorshme se ato me te cilat u jane ofruar me pare ortakeve te tjere duke respektuar te drejten e parablerjes se ortakeve.
- Transferimi i pjeseve te kapitali do te kryhet ne baze te dispozitave te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- Veprimet e mesiperme do te evidentohen ne regjistrin e shoqerise.

KAPITULLI V
Administrimi i shoqerise

Neni 11
Administrimi

- Organet drejtuese te shoqerise "**BE MAD**" sh.p.k jane:
 - a) **Asambleja e Pergjithshme** apo **Ortaku i Vetem**, i cili eshte organi me i larte vendim-marres.
 - b) **Administratori** i shoqerise i emeruar me vendim te Asamblese se Ortakeve, bazuar ne dispozitat perkatese ligjore.

Neni 12
MARRJA E VENDIMEVE

- Asambleja, rregullisht e thirrur dhe e perbere prej ortakeve te shoqerise, perfaqeson vullnetin e ortakeve. Vendimet e marra prej saj, per sa kohe qe jane te vlefshme ne perputhje me ligjin dhe me kete statut, detyrojne te gjitha anetaret e asamblese edhe pse jo te pranishem dhe jo dakort.
- Cdo ortak ka te drejte te marre pjese ne mbledhjet e asamblese personalisht dhe disponon nje numer votash te barabarta me pjeset e kapitalit themeltar qe ai zoteron. Cdo ortak ka te drejte te perfaqesohet ne Asamble nga persona te trete duke u leshuar atyre prokure te posacme per cdo mbledhje te asamblese.
- Vendimet, ne mungese te prezences se ortakeve, mund te merren pas konsultimit me shkrim te tyre, ne rast se te gjitha ortakët miratojne me shkrim permbajtjen e konsultimit. Ne kete rast zbatohen procedurat e percaktuara nga ligji tregtar.
- Ortaket lajmerohen per zhvillimin e mbledhjes se Asamblese me shkrese apo me mesazh elektronik, i cili duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites jo me vone se 7 dite perpara dates se mbledhjes.

- Mbledhja e asamblese mund te thirret nga Administratori i shoqerise, nga nje ose disa prej ortakeve te shoqerise qe zoterojne te pakten 5% te pjeseve te kapitalit themeltar.
- Cdo mbledhje e asamblese e thirrur ne menyre te parregullt, mund te anulohet. Anullimi nuk ka vlere, ne rast se te gjithë ortaket jane te pranishem ose te perfaqesuar.

NENI 13

KOMPETENCAT E ASAMBLES SE PERGJITHSHME

- Asambleja e pergjitheshme apo Ortaku i vetem, pervec te tjerave, eshte i vetmi organ qe vendos per:
 - emerimin ose shkarkimin e administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujdusesve;
 - percaktimin e shperblimeve per administratorin, ekspertin kontabel dhe likujdsuesve;
 - percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te te ecurise se veprimtarise;
 - miratimin e raporteve te administrimit dhe te kontrollit;
 - miratimin e llogarive vjetore, disponimin e fitimit, etj;
 - ndryshimet e statutit;
 - zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar;
 - pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - perfaqesimin e shoqerise ne Gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet;
 - zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise apo prishjen e saj dhe kalimin ne proces likuidimi;

- shnderrimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne forma te tjera;
- etj.

NENI 14 KUORUMI

- Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme ne qofte se jane te pranishem ose te perfaqesuar nje ose disa ortake qe zoterojne mbi 30% te pjeseve te kapitalit themeltar. Ne rastet kur Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ceshtje si : ***Ndryshimin e Statutit, Zmadhimin ose Zvogelimin e kapitalit te rregjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise*** ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se 50% te kapitalit jane te pranishem.
- Ne qoftese mbledhja e Asamblese se Pergjithshme nuk realizohet per mungese kuorumi, thirret mbledhja e dyte brenda 30 diteve me te njejtin rend. Edhe ne kete rast vendimet te vlefshme merren vetem nese eshte formalizuar kuorumi i nevojshem ne varesi te ceshtjes, rend dite.
- Ndryshimet e statutit, transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar tek te tretet, zmadhimi apo zvogelimi i kapitalit te rregjistruar, shperndarja e fitimeve riorganizimi apo prishja e shoqerise dhe kalimi ne proces likuidimi, shnderrimi ne nje forme tjeter, vendosen ne mbledhjen e asamblese vetem kur kuorumi i kerkuar perbehet nga ortaket qe zoterojne me shume se $\frac{1}{2}$ e kapitalit themeltar dhe vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesemarres.
- Asambleja drejtohet nga nje anetar i zgjedhur nga ortaket e pranishem. Te gjitha vendimet e Asamblese transkriptohen dhe ruhen ne rregjistrat e shoqerise. Ne rastet e percaktuara me ligj, vendimet e asamblese duhet te rregjistrohen ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

- **Dispozitat e mesiperme ne lidhje me menyren dhe kuorumin e kerkuar per marrjen e vendimeve, zbatohen ne rast se shoqeria do te zoterohet nga me shume se nje Ortak.**

Neni 15

Administratori

- Administratori, i cili mund te kete cdo lloj shtetesisie, do te zgjidhet per nje periudhe dy vjecare dhe eshte i rizgjedhshem.
- Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator. Kete detyre do ta kryeje per periudhen e pare prej dy vjetesh, Znj. Dea ELEZI.
- Ne rast vdekjeje, doreheqje, shkarkimi ose skualifikimi te Administratorit, zevendesuesi i ketij te fundit do te zgjidhet nepermjet vendimit te Asamblese se Ortakeve, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
- Pas pranimit te detyres, administratori do te deklaroje me shkrim se detyra e tij do te kryhet ne baze te mirebesimit; ne kete aspekt shkarkimi i tij nepermjet vendimit te Asamblese se Ortakeve, bazuar dhe ne dispozitat ligjore, eshte menduar si nje arsye e perligjur per shkarkim.
- Asambleja e Ortakeve gezon te drejten te liroje nga detyra, me shkrim, administratorin. Ne rast te nje shkarkimi te paarsyeshem ky i fundit gezon te drejten per shperblim financiar, sipas ligjit.
- Veprimtaria e perditshme e shoqerise drejtohet nga administratori, i cili per realizimin e qellimeve te shoqerise dhe te aktivitetit te biznesit te saj ka te drejte te firmose ceqe, urdhera, kontrata te ndryshme, kontrata qiraje, njoftime, si dhe cdo dokument tjeter te nevojshem per kete qellim. Gjithashtu administratori ka te drejten te nenshkruaje

cdo dokument qe behet ne emer te shoqerise, pervec rasteve kur kjo bie ne kundershkrim me ndonje dispozite ligjore ose kur shoqeria, me vendim te Asamblese se Ortakeve, ka ngarkuar dike tjeter per kryerjen e ketij veprimi.

- Administratori do te pergatise biznes-planin e cdo viti financiar, i cili do te miratohet me vendim te Asamblese se Ortakeve.
- Administratori gjate kryerjes se veprimtarise se tij duhet te permbushe detyrimet qe rrjedhin nga dispozitat ligjore, Statutit i shoqerise dhe dispozitat e tjera qe rregullojne kete veprimtari dhe te raportoje perpara Asamblese se Ortakeve kur nje gje e tille kerkohet prej tyre.
- Administratori duhet te kryeje detyrat qe do t'i ngarkohen nga Asambleja e Ortakeve, dhe mund t'i delegoje keto detyra ne teresi apo pjeserisht tek pjesetare te tjere te shoqerise, ose ndermjet tyre, ne zbatim te rregullave te menaxhimit qe rregullojne ndarjen e biznesit si dhe procedurat per vendimet e menaxhimit te marra prej Asamblese.
- Cdo veprim i administratorit, qe del jashte kuadrit te veprimtarise normale te tij, duhet te miratohet me pare nga Asambleja e Ortakeve.

Neni 16

Veprimet e Biznesit qe kerkojne miratimin paraprak te Asamblese se Ortakeve

- Administratori nuk mund te perfundoje transaksione biznesi qe dalin jashte kuadrit te veprimtarise normale te aktivitetit te shoqerise, pa miratimin paraprak te Asamblese se Ortakeve.
- Secila nga vendimet dhe transaksionet e listuara me poshte, kerkojne miratimin paraprak te Asamblese se Ortakeve:

- (a) dhenie prej shoqerise e financimeve, kredive, sigurimeve, garancive, ose rritja e zvogelimi i kapitalit, dhe marrja hua nga persona te trete qofshin keta persona juridik apo fizik;
- (b) perfundimi, mbarimi, apo amendimi i nje dispozite thelbesore te kontratave qe e kalojne kohezgjatjen prej tre vjetesh ose qe kalojne vleren prej 10 000 000 Leke;
- (c) shitja e aseteve te shoqerise;
- (d) marrja e interesave pasurore ne nje shoqeri, ortakeri ose grupim ne nje sipermarrje tjeter, themelimi i nje shoqerie te ndervarur , blerja e shitja e aksioneve ose pjeseve apo te drejtave te tjera ne nje sipermarrje te shoqerise, qe gjen zbatim nga ligjet e aplikueshme;
- (e) dhenia apo heqja e prokurave te pergjithshme ose te atyre qe kane nje kohezgjatje te papercaktuar;
- (f) punesimi i stafit me nje rroge vjetore me te madhe se 120 000 Leke;
- (g) blerja ose tjetersimi i pasurive te paluajtshme dhe vendosja e barres mbi te;
- (h) cdo ndryshim apo devijim nga Plani i Biznesit.

Neni 17

Miratimi i llogarive

- Administratori do te mbaje llogarite perkatese dhe hartoje raportin financiar perfundimtar ku do te pasqyrohet ne menyre te detajuar gjendja financiare e shoqerise ne perputhje me zerat kryesor te llogarive. Llogarite dhe raporti financiar vjetor do te pergatiten ne forme ne perputhje me standartet e llogarive te parashikuara ne ligj.
- Asambleja e Ortakeve emerone te pakten nje Auditor te jashtem te certifikuar, qe do te kete keto pergjegjesi:
 - (a) te auditoje llogarite e shoqerise dhe regjistrimet e veprimtarise se biznesit;
 - (b) te certifikojë, ne perputhje me rregulloret perkatese, raportin vjetor te llogarive financiare (bilancin, fitimin dhe humbjet dhe deklarimet e

lidhura me to) dhe te leshoje nje opinion qe ky raport pasqyron gjendjen financiare reale te shoqerise;

- (c) te informoje Administratorin dhe ortaket e shoqerise per cdo parregullsi dhe mangesi te verejtur ne procedurat, veprimtarine dhe transaksionet e biznesit qe mund te cojne ne humbje te shoqerise;
- (d) te rishikojte saktesine e Auditorit te brendshem dhe te kontrolloje praktikat dhe procedurat, dhe nese e gjykon te nevojshme te beje rekomandimet perkatese per permiresimet e mundshme; dhe
- (e) te permbushe detyrimet qe rrjedhin nga ligji nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe nga ligjet e tjera te aplikueshme.

Neni 18

- Shperndarja e dividendeve do te behet ne perputhje me dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe te ligjeve te tjera te aplikueshme.
- Te gjitha ceshtjet, te cilat nuk jane te specifikuara ne kete statut, do ti nenshtrohen dispozitave te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe amendimeve te mundshme te tij.

KAPITULLI VI

KUFIZIMI I AFATIT, PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE

NENI 19

NDRYSHIMET E AFATIT

- Kufizimi apo zgjatja e afatit te aktivitetit te shoqerise mund te vendoset nga Asambleja e Ortakeve me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit themeltar apo nga vete Ortaku i Vetem.

NENI 20

PRISHJA E SHOQERISE

- Shoqeria prishet ne perputhje me kushtet e percaktuara ne kete statut, me vendim te Asamblese se Ortakeve me kerkesen e 3/4 te pjesmarrjes ne kapitalin themeltar apo me vendimin e Ortakut te Vetem.

- Shkaqet e prishjes se Shoqerise;
 - a. kur mbaron kohezgjatje e parashikuar ne themelimin e saj;
 - b. me vendim te Asamblese se Pergjithshme apo te Ortakut te Vetem;
 - c. me hapjen e procedurave te falimentimit;
 - d. nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne Q.K.R;
 - e. me Vendim Gjykate;

Shoqeria nuk prishet kur njeri nga ortaket falimenton, behet i paafte ose vdes.

NENI 21

LIKUIDIMI I SHOQERISE

- Shoqeria hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e prishjes se saj. Per kryerjen e ketij procesi Asambleja apo Ortaku i Vetem emeron nje ose disa likuidues te cilet i paraqesin asaj/atij raportin mbi gjendjen e aktivitet dhe te pasivitet te shoqerise, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe mbi afatin e domosdoshem te perfundimit te tyre.
- Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja me shumicen e ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit themeltar apo Ortaku i Vetem vendos, mbi bilancin perfundimtar financiar, mbi aktin e rregullshmerise te punes se likuiduesit dhe mbylljen e procesit te likuidimit.
- Pas pagimit te kreditoreve dhe shlyerjes se pjeseve te kapitalit themeltar tek kontribuesit perkates, likuiduesi ndan kapitalet e

mbetura ndermjet ortakeve proporcionalisht me pjeset qe ata zoterojne ne kapitalin themeltar dhe njofton Q.K.R per perfundimin e likujdimit dhe kerkon c'rregjistrimin e Shoqerise.

KREU VII

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 22

SHNDERRIMI I SHOQERISE

- Shnderrimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ne shoqeri aksionere mund te kryhet me miratim unanim te ortakeve, ndersa shnderrimi ne shoqeri aksionere, me miratimin e shumices se ortakeve qe zoterojne mbi 3/4 e kapitalit themeltar.
- Marredheniet e brendshme ndermjet punetoreve dhe shoqerise midis tyre dhe organeve te shoqerise do te rregullohen me anen e nje rregulloreje.

NENI 23

INTERPRETIMET STATUTORE

- Pavlefshmeria e dispozitave te vecanta te kesaj marreveshje nuk e prek teresine e saj vepruese. Ne vend te dispozitave te pavlefshme ose per mbushjen e hapsirave statutore, ortaket bien dakord per nje rregullim te pershtatshem, ne perputhje me qellimin e hartimit te ketij statuti, duke ruajtur interesat e perbashketa.
- Per gjithshka jo te parashikuar ne kete statut do te respektohen normat ligjore te legjislacionit shqiptar ne fuqi.
- Gjykate kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarreveshjeve qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise, ose gjate periudhes se likujdimit ndermjet ortakeve, ndermjet shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet shoqerise dhe te treteve, do te jete **Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.**

- Ky Statut hartohet ne 4 ekzemplare origjinale, hyn ne fuqi ditën e nenshkimit nga Ortaket e Shoqërisë “**BE MAD**” SH.P.K.

NENI 24

DISPOZITA TE FUNDIT

- Per te gjitha çështjet qe nuk gjejne rregullim ne kete Statut, aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Per tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- Per efekt te interpretimit te ketij Statuti me ligj tregtar nenkuptohet ligji nr. 9901 dt. 14.04.2008 “Per tregëtarët dhe shoqëritë tregtare”
- Pavlefshmerite eventuale te dispozitave te veçanta te Statutit nuk mund te cenojne vlefshmerine ne teresi te tij.

ORTAKU I VETEM

Znj. Dea ELEZI

